



Pranuar / Dorezuar Punëhënë/Prodato Received/Delivered	03.11.2022	2 viti god year	
Organ /Njësia Organ /Jedimica Org.-Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPM/SHCK	6687/2022		113



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.820/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë, si dhe Zyle Millaku Gojnovci-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.820/2022 të datës 23.09.2022 të parashtruar nga grupi i ankueseve:

të cilët me autorizim i përfaqëson

kundër organit

të punësimit/Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, në çështjen juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 03.11.2022, mori këtë:

V E N D I M

HEDHET POSHTË si e palejuar ankesa me numër A.nr.820/2022, e datës 23.09.2022 e parashtruar nga ankuesit

A r s y e t i m

Ankueset e punësuar në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, sipas Akte emërimit të datës 04.04.2014 në pozitën "Zyrtare e lartë për monitorimin dhe Inspektimin e Ofertave të Shërbimeve Sociale(OJQ-ve)", sipas Akte emërimit të datës 04.02.2020 në pozitën "Zyrtare e lartë për Planifikim dhe Projekte", sipas Akte emërimit të datës 02.04.2014 në pozitën "Zyrtare e Lartë për Hartimin e Politikave Sociale", dhe sipas Akte emërimit të datës 02.04.2014 në pozitën "Udhëheqës i Divizionit të Aftësisë së Kufizuar dhe Personave të Moshuar" përmes përfaqësueses së autorizuar me datën 06.09.2022 kanë parashtruar kërkesë me numër prot.1913-1/2022 në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve lidhur me kompensimin e pagës jubilarë, shujtave ditore si dhe shtesave të tjera, ndërsa me datën 23.09.2022 përmes përfaqësues ligjore kanë parashtruar ankesën me numër te protokollit 5634/2022, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, lidhur me kompensimin e pagave jubilarë, shujtave ditore dhe shtesave tjera.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datën 07.10.2022 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, ndërsa me datën 17.10.2022 kjo e fundit ka përcjellë dokumentacionin lidhur me ankesën e ankueses së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave për marrjen e vendimit meritor administroj këto prova: Ankesën me numër te protokollit 5634/2022 të datës 23.09.2022 ne Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Kërkesë e datës 06.09.2022 me numër protokollit 1913-1/2022 kompensimit të pagave jubilarë, shujtave ditore prej dy (2) euro, dhe shtesave të tjera; Akte emërimit të datës 04.02.2020 për [redacted] Autorizim i datës 14.09.2020 për katër (4) ankuesit veç e veç; Vërtetim i datës 14.07.2021 nr. Protokollit 1660; Akte emërimit të datës 04.02.2020 për [redacted] Vërtetim i datës 14.07.2021 nr. Protokollit 1662; Vërtetim i datës 14.07.2021 nr. Protokollit 1664; Akte emërimit të datës 02.04.2014 për [redacted] Akte emërimit të datës 02.04.2014 për [redacted] Vërtetim i datës 14.07.2021 nr. Protokollit 1661; Përgjigje ne ankesë e datës 17.10.2022 përmes emailit zyrtar të Njësisë së personelit, Lista e pagës e datës 31.08.2017 për ankuesen [redacted] Lista e pagës e datës 30.09.2022 për ankuesen për [redacted] e pagës e datës 31.08.2017 për ankuesen për [redacted] Lista e pagës e dates 01.10.2022 për ankuesin për [redacted]

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dërguara nga ankuesja dhe organi i punësimit, ka konstatuar se ankesa e ankuesve, është e palejuar, sepse:

Ankuesit [redacted] e punësuar në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, sipas Akte emërimit të datës 04.04.2014 në pozitën "Zyrtare e lartë për monitorimin dhe Inspektimin e Ofertave të Shërbimeve Sociale(OJQ-ve)", [redacted] sipas Akte emërimit të datës 04.02.2020 në pozitën "Zyrtare e lartë për Planifikim dhe Projekte", [redacted] sipas Akte emërimit të datës 02.04.2014 në pozitën "Zyrtare e Lartë për Hartimin e Politikave Sociale", dhe [redacted] sipas Akte emërimit të datës 02.04.2014 në pozitën "Udhëheqës i Divizionit të Aftësisë së Kufizuar dhe Personave të Moshuar" përmes përfaqësueses se autorizuar me datën 06.09.2022 kanë parashtruar kërkesë me numër prot.1913-1/2022 në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve lidhur me kompensimin e pagës jubilarë, shujtave ditore si dhe shtesave të tjera, mirëpo ankuesit deri me datën 23.09.2022 nuk ka marr përgjigje nga organi i punësimit dhe me datë 23.09.2022 përmes përfaqësues ligjore kanë parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, lidhur me kompensimin e pagave jubilarë, shujtave ditore dhe shtesave tjera.

Kolegji i Këshillit lidhur me pranueshmërinë e ankesës së ankueseve, analizoi dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, gjegjësisht nenin 98 paragrafin 1 dhe 2, ku përcaktohet se: 1. *Procedura administrative nisur sipas kërkesës, do të përfundojë sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se sa afati i përcaktuar me ligj të veçantë për atë lloj procedure.* 2. *Në rast se ligji i veçantë nuk ka paraparë një afat, siç është paraparë në paragrafin 1 të këtij neni, afati i përgjithshëm i zbatueshëm për përfundimin e procedurës administrative është dyzetepesë (45) ditë nga fillimi i saj*", andaj duke marre parasysh dëshmitë e ofruara nga ankuesit dhe organi i punësimit Kolegji konstatoi se ankueset përmes përfaqësueses se autorizuar më datë 06.09.2022 kanë parashtruar kërkesë me numër



prot.1913-1/2022 në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve lidhur me kompensimin e pagës jubilarë, shujtave ditore si dhe shtesave të tjera, ndërsa me datë 23.09.2022 përmes përfaqësues ligjore kanë parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Andaj Kolegji i Këshillit në bazë të shkresave të lëndës vlerëson se parashtrimi i ankesës nga ankueset, me datë 23.09.2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës është e para afatëshme respektivisht ankesa nga ankueset është parashtruar ende pa përfunduar afati i përcaktuar ligjor për përfundimin e procedurës administrative prej dyzetepesë (45) ditëve ashtu siç përcaktohet me nenin 98 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, kështu që Kolegji i Këshillit duke u bazuar në faktet e lartcekura konstatoi se ankesa e ankueseve është e palejuar në kuptim të nenit 125 paragrafi 1 dhe nenit 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 ndërlidhur me nenin 127 paragrafi 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
lënda me numër A.nr.820/2022

Zyle Millaku Gojnovci

Procesmbajtëse

Malsore GASHI BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësueses ligjore të ankueseve
- Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

